

Komisionerja për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil zhvillon vizitë pune në Kosovë

Komisionerja për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në Republikën e Shqipërisë, znj. Leterije Lleshi (Luzi), së bashku me stafin e saj, zhvilloi një vizitë pune dy ditore në Republikën e Kosovës, ku pati takime me Kryetarin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, z. Arben Mehmeti dhe zyrtarët kryesorë të këtij institucioni.



Gjatë takimeve, Komisionerja, znj. Leterije Lleshi (Luzi) dhe homologu i saj, z. Arben Mehmeti diskutuan mbi sfidat dhe zhvillimet në administrimin e shërbimit civil në Shqipëri dhe Kosovë.

Duke u ndalur edhe në zhvillimet në Kosovë, vëmendja u përqëndrua te rëndësia e shkëmbimit të praktikave më të mira të mbikëqyrjes së sjelljes së nëpunësve civilë, gjatë procesve elektorale, për të garantuar standardet e aplikuara në legjislacionin për shërbimin civil.



Bashkëbiseduesit shprehën me tej vullnetin për të krijuar lidhje më të ngushta institucionale, duke u mbështetur në marrëveshjen ekzistuese të bashkëpunimit mes Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil të Republikës së Shqipërisë.



Vizita në Kosovë e Komisioneres për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, znj. Lefterije Lleshi (Luzi), u realizua me ftesë të Kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, z. Arben Mehmeti.